



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-2020-11

Vendosi: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, kryegjykatës
Gjykatës Antonio Balsamo
Gjykatës Roumen Nenkov

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 5 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Emri i dosjes: Referim lidhur me ndryshimet e propozuara të Kushtetutës së Kosovës

Klasifikimi: Publik

Vendim për njoftimin e referimit dhe kërkesë për informacion

Presidentit të Kosovës
Hashim Thaçi

Kryeministrit të Kosovës
Avdullah Hoti

Kryetares së Kuvendit të Kosovës
Vjosa Osmani – Sadriu

Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara
Pietro Spera

Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë/Zëvendëspresidentit të Komisionit Evropian
Josep Borrell Fontelles

Shefit të Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX)
Lars-Gunnar Wigemark

I. HISTORIKU NË LIDHJE ME REFERIMIN

A. SHKËMBIMI I LETRAVE

1. Më 14 prill 2014, Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë/Zëvendëspresidentja e Komisionit Evropian shkëmbyen letra në lidhje me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe themelimin dhe funksionimin e një “gjykate të specializuar” dhe një “zyre të prokurorit të specializuar” për procedura që mund të rezultojnë nga hetimet e Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS) (“Shkëmbimi i Letrave”).

2. Shkëmbimi i Letrave parashikonte që Kosova të miratonte të gjitha masat ligjore në përputhje me legjislacionin e vet për themelimin e një “gjykate të specializuar” dhe një “zyre të prokurorit të specializuar” në lidhje me hetimet e TFHS-së, duke përfshirë, sipas nevojës, edhe amendamente kushtetuese të mundshme. Shkëmbimi i Letrave gjithashtu parashikon konsultimet gjatë procesit të ndryshimit të ligjeve të Kosovës që kanë ndikim në zbatimin e mandatit të EULEX-it në Kosovë, ose në procedurat gjyqësore që dalin nga hetimet e TFHS-së.

B. RATIFIKIMI I SHKËMBIMIT TË LETRAVE

3. Më 23 prill 2014, Kuvendi i Kosovës, me anë të ligjit nr. 04/L-274, ratifikoi Shkëmbimin e Letrave si një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

C. AMENDAMENTI KUSHTETUES

4. Më 7 mars 2015, Qeveria e Kosovës propozoi një amendament të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”), përkatësisht që pas nenit 161 të Kushtetutës të

shtohet neni i ri 162 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“amendamenti”).¹

5. Më 9 mars 2015, në pajtim me nenet 113(9) dhe 144(3) të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës amendamentin e propozuar për vlerësim paraprak nëse amendamenti i propozuar nuk pakësonte të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.²

6. Më 14 prill 2015,³ Gjykata Kushtetuese e Kosovës konfirmoi se amendamenti i propozuar nuk pakësonte të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II dhe Kapitullin III të Kushtetutës dhe me frymën e me tekstin e saj. Gjykata Kushtetuese theksoi se përfshirja e amendamentit buronte nga Marrëveshja Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian e 14 prillit 2014 (shih paragrafët 1-3 më lart).⁴

7. Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës ndryshoi Kushtetutën, duke shtuar pas nenit 161, nenin e ri 162 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

D. AMENDAMENTI I PROPOZUAR KUSHTETUES

8. Më 24 gusht 2020, Presidenti i Kosovës propozoi një amendament të nenit 162 të Kushtetutës (“amendamenti i propozuar”).⁵

¹ Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me Shkresën nr. 05-433/DO-318*, Rasti nr. KO 26/15, Aktgjykim, 14 prill 2015 (15 prill 2015), para. 13.

² Po aty, para. 1, 14.

³ Po aty, para. 9.

⁴ Po aty, para. 37.

⁵ KSC-CC-2020-11, F00001, A01 Amendamentet e propozuara të Kushtetutës (protokolluar më 21 shtator 2020).

II. REFERIMI

9. Më 18 shtator 2020, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës i përcolli Kryetares së Dhomave të Specializuara amendamentin e propozuar, në pajtim me nenet 144(3) dhe 162(3) të Kushtetutës (“referimi”).⁶

10. Në veçanti, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës i kërkoi Kryetares së Dhomave të Specializuara që t’i caktonte referimin Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, për të shqyrtuar nëse amendamenti i propozuar kushtetues nuk i pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

11. Më 22 shtator 2020, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin me përbërjen si më lart, për të marrë vendim mbi referimin.⁷

III. NJOFTIMI DHE KËRKESA PËR INFORMACION

A. DISPOZITAT PËRKATËSE

12. Fillimisht, paneli thekson se sipas nenit 162(3) të Kushtetutës dhe nenit 49(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), kjo Dhomë ka juridiksion ekskluziv mbi referimet kushtetuese sipas nenit 113 të Kushtetutës në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Në këtë kontekst, paneli vë në dukje se amendamenti i propozuar ka të bëjë me nenin 162 të Kushtetutës për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

13. Paneli thekson gjithashtu se sipas rregullës 15(2) të Rregullores së Punës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, paneli mund të kërkojë informacion

⁶ KSC-CC-2020-11, F00001, Shkresë e Kryetares së Kuvendit të Kosovës, publike, 18 shtator 2020, me shtojcën A01 (protokolluar më 21 shtator 2020).

⁷ KSC-CC-2020-11, F00002, Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 shtator 2020.

plotësues ose parashtrime shtesë në lidhje me referimin, në qoftë se e gjykon të nevojshme.

B. NJOFTIMI

14. Në përputhje me sa më lart dhe duke marrë parasysh rrethanat në lidhje me referimin për sa u përket autoriteteve që mund të jenë të interesuara në këto procedura (shih paragrafët 1, 4 dhe 8 më lart), paneli e gjykon të përshtatshme që për referimin të njoftojë autoritetet e mëposhtme, me mundësinë që të paraqesin parashtrimet e tyre me shkrim, në qoftë se dëshirojnë, në lidhje me pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e referimit: Presidentin e Kosovës, Përfaqësuesin e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë/Zëvendëspresidentin e Komisionit Evropian, Kryeministrin e Kosovës dhe shefin e Misionit të EULEX-it në Kosovë.

15. Paneli thekson gjithashtu se sipas nenit 162(11) të Kushtetutës, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara ka përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Po ashtu, sipas rregullës 28(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, Avokati i Popullit mbron dhe ruan të drejtat dhe liritë themelore të mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës, të personave që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Duke mbajtur parasysh këtë kompetencë të Avokatit të Popullit, paneli e gjykon të përshtatshme që për referimin të njoftojë Avokatin e Popullit, me mundësinë që të paraqesë parashtrimet e veta me shkrim, në qoftë se dëshiron, në lidhje me pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e referimit.

C. KËRKESA PËR INFORMACION

16. Përveç kësaj dhe për vlerësimin e duhur të referimit, Dhoma e gjykon të përshtatshme që të kërkojë nga Presidenti i Kosovës t'i dorëzojë panelit informacion lidhur me arsyet për amendamentin e propozuar të nenit 162 të Kushtetutës, përfshirë edhe kopje të punës përgatitore të mundshme apo të materialeve të tjera të ngjashme.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, PANELI I GJYKATËS KUSHTETUESE

1. *Vendos* që për referimin të njoftojë autoritetet e mëposhtme, me mundësinë që deri me 19 tetor 2020 të paraqesin parashtrimet e tyre me shkrim, në qoftë se dëshirojnë, në lidhje me pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e referimit:

Presidentin e Kosovës;

Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë/Zëvendëspresidentin e Komisionit Evropian;

Kryeministrin e Kosovës;

Avokatin e Popullit të Dhomave të Specializuara; dhe

Shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

2. *I kërkon* Zyrës Administrative të Dhomave të Specializuara që autoriteteve të lartpërmendura t'u dorëzojë nga një kopje të referimit KSC-CC-2020-11, F00001, Shkresë e Kryetares së Kuvendit të Kosovës, me klasifikim publik, të datës 18 shtator 2020, përfshirë të shtojcës së tij A01.

3. *Autorizon* që parashtrimet me shkrim, në qoftë se do të ketë, krahas anglishtes si gjuhë e punës e kësaj procedure,⁸ të mund të paraqiten edhe në gjuhën shqipe ose serbishte, me përkthimin zyrtar në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, përkatësisht në gjuhën shqipe, serbishte dhe anglishte, të mundësuar nga Zyra Administrative e Dhomave të Specializuara.

4. *Urdhëron* që parashtrimet me shkrim, në qoftë se do të ketë, të mos tejkalojnë 10 faqe.

5. *I kërkon* Presidentit të Kosovës që deri me 19 tetor 2020 t'i dorëzojë panelit informacion lidhur me arsyet për amendamentin e propozuar të nenit 162 të

⁸ KSC-CC-2020-11, F00003, Vendim për gjuhën e punës, publik, 24 shtator 2020.

Kushtetutës, përfshirë edhe kopje të punës përgatitore të mundshme apo të materialeve të tjera të ngjashme.

 /nënshkrim/
Gjykatës Vidar Stensland
Kryegjykatës

Hartuar në anglishte, e hënë, 5 tetor 2020

Në Hagë, Holandë